



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:245341
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05535820

Ac.nr.7720/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ministria e Bujqësisë dhe Pylltarisë-Agjencia Pyjore e Kosovës, kundër të paditurit I.G , për kompensim demi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2297/18 e datës 13.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 25/03/2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurit I.G dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2297/18 e datës 13.04.2021.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin ankimor C.nr.2297/18 e datës 13.04.2021, ka vendosur si vijon:

I.APROVOHET si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditëses Ministria e Bujqësisë dhe Pylltarisë-Agjencia Pyjore e Kosovës ashtu që DETYROHET i padituri I.G, që paditëses t'ia paguaj në emër të kompensimit dëmit material, shumën prej 501.30 euro, me kamatë ligjore në lartësinë prej 8%, prej datës 25 korrik 2018, dita kur është ushtruar padia, e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur i padituri, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Paditësja nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, nenit 195.1, pika d) dhe nenit 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, në gjykatën e shkallës së parë, me datën 25.07.2018, ka paraqitur padi kundër të paditurit, për kompensim demi, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.1464/16 të datës 15.02.2018, vërtetohet fakti se i padituri I.G, është shpallur fajtor dhe është dënuar me gjobë në shumën prej 400 euro për shkak të veprës penale Vjedhje Pylli. Nga Aktgjykimi në fjalë del që i padituri ka pranuar fajësinë në lidhje me veprën në fjalë, dhe se lartësia e dëmit të konstatuar si rezultat i veprës penale ka qenë në shumën prej 501.30 euro. Me aktgjykimin e lartpërmendur dëmtuara tani paditësja është udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta bëjë në kontest civil, kundrejt të akuzuarit, tani të paditurit I.G.Nga Fletëparaqitja e rojës së pyllit të përpiluar me datë 10.12.2015 është vërtetuar fakti se i padituri I.G ka shkaktuar dëm pyjor në vëllim prej 5.57 m² në vlerë prej 501.30 euro. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë është referuar neneve 136, 169.2 dhe 171.1 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala e paditur me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i të paditurit për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadsisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të administruara i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, gjegjësisht në shkresat e lëndës ekziston aktgjykimi penal me të cilin është vërtetuar se i padituri është shpallur fajtor dhe është dënuar sipas ligjit, për shkaktimin e dëmit që e ka pësuar paditësja. Sipas nenit 7.1 të LPK-së parashihet: Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa

neni 322.3 i po këtij ligji parasheh: Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese edhe sa i përket zbatimit të gabuar të ligjit material, pasi që kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë sepse në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 136 të LMD-së, e cila dispozitë parasheh se: Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij ndërsa neni 169.1 i LMD-së, parasheh se *Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi*. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkëlqje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.7720/21, me datë 25/03/2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku